



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MARGENA U. ÇELA
ADRESA Astrit BALLUKU
TEL: 695244272**

KONTRATA TË TJERA

(KONTRATË BASHKËPUNIMI)

Nr. repertori: 1210

Nr. koleksioni: 490

Tirane më 14/04/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2023053120056257106



A2023053120056257106

KONTRATË BASHKËPUNIMI
(Për bashkimin e operatorëve ekonomikë)

Sot, para meje Noter MARGENA U. ÇELA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Astrit BALLUKU, u paraqit personalisht:

PALA 1: Shoqëria FAB CONSTRUCTION, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L22209024A, me seli në adresë Rruga Herman Gmeiner, Nr. 77, Pasuria Me Nr. 13/21+1-2, Zonë Kadastrale Nr. 3266, Kodi Unik 3266019230, përfaqësuar nga Administratori Shaban Xhabrahimi, atësia Mustafa, amësia Time, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Herman Gmainer; Nd. 77; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 30/06/1965, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034049615 dhe nr. personal G50630121S.

PALA 2: Shoqëria A.TOTO, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS J64102219M, me seli në adresë Lagjja Hasan, Ndertese Private, 3 Kateshe, Prane Karburant Kastrati, përfaqësuar nga Administratori Andrea Toto, atësia Vangjel, amësia Mila, shtetas Shqiptar, lindur në Fushë Krujë, Krujë dhe banues në Tiranë, me adresë Sh. Ishmi; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 17/05/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033918146 dhe nr. personal G70517135C.

Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate bashkëpunimi mes operatorëve ekonomikë. Unë noterja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

OBJEKTI: "Bashkimin e përkohshëm të Shoqërive", në kuptim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTIVI I KONTRATËS

Të dy palët janë madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe kanë rënë dakord që të lidhin këtë Kontratë për Bashkim të Përkohshëm të Shoqërive të tyre për, për mbështetje deri në realizimin/përfundimin e projektit Grand Hotel Borsh, me mbështetje financiare, njerëzore, ligjore dhe asete deri në masën respektive sipas kuotave/aksioneve që gëzojnë në shoqërinë Grand Hotel Borsh shpk.

Kjo marrëveshje Joint Venture lidhet ndërmjet shoqërisë "Fab Construction" shpk, aktualisht ortak e Shoqërisë "Grand Hotel Borsh" shpk me 70 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, dhe shoqërisë "A. TOTO" shpk, aktualisht ortak e Shoqërisë "Grand Hotel Borsh" shpk me 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, me qëllim mbështetjen e realizimit të projektit të Grand Hotel Borsh. Ky bashkim i Përkohshëm ndërmjet tyre ka për qëllim për të përmbushur dhe finalizuar kapacitetet e kërkuara për financimin, realizimin dhe menaxhimin e projektit Grand Hotel Borsh.

I. TË DREJTAT DHE KONTRIBUTET E PALËVE

Palët e mësipërme, nëpërmjet Përfaqësuesve të tyre, me vullnet të lirë e të plotë, më deklaruan se kanë rënë dakord për një bashkim të përkohshëm të shoqërive të tyre për të mbështetur projektin e Grand Hotel Borsh.



A2023053120056257106

Në këtë bashkim të përkohshëm, në bazë dhe të vendimeve respektive të marra prej organeve drejtuese të tyre, të dyja shoqëritë do të marrin pjesë në mënyrë solidare duke marrë përsipër të drejta dhe detyrime sipas kuotave në shoqërinë Grand Hotel Borsh.

Shoqëritë do të kenë në mënyrë të vecantë të drejtën dhe detyrimin për të siguruar të gjithë kapacitetin e nevojshëm Teknik për zhvillimin e projektit për të siguruar asistencën ligjore të nevojshme, mbështetje financiare dhe burime njerëzore deri në ekzekutimin e projektit dhe përfundimin e të gjitha veprave që do të ndërtohen nga Grand Hotel Borsh.

Palët marrin përsipër të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm financiar dhe ligjor në përputhje me specifikimet ligjore që do të kërkojë realizimi i projektit të Grand Hotel Borsh.

Palët në vijim, me deklarojnë se kanë rënë dakord midis tyre që, në kushtet e mbështetjes së projektit, autorizojnë Shoqërinë Grand Hotel Bosh shpk ti përfaqësojë deri në realizimin e Kontratës si dhe në çdo procedurë me institucionet shtetërore.

Në përfundim të projektit, secila prej shoqërive gëzon të drejtat dhe përfiton në raport me përqindjen e aksioneve që kanë në shoqërinë Grand Hotel Borsh shpk.

Kushtet e kësaj kontrate mund të ndryshohen vetëm me marrëveshje të shkruar ë palëve.

Kjo Kontratë u redaktua në katër kopje origjinale të barazvlefshme, në bazë të Nenit 659 e vijues të Kodit Civil, e cila, në vijim ju lexohet qartë Palëve, që e dëgjuan, e vërtetuan, e nënshkruan në praninë time dhe unë Noterja MARGENA U. ÇELA e vërtetoj në bazë të Ligjit Nr 110 dt 20.12.2018 "Për noterinë" si shprehje të vullnetit të lirë e të plotë të tyre.


PALËT KONTRAKTORE

FAB Construction sh.p.k.
Administrator/Ortak i vetëm
Shaban XHABRAHIMI

FAB CONSTRUCTION Sh.p.k.
NUIIS: L 22209024 A
Tirane - Albania

A TOTO sh.p.k
Administrator/Ortak
Andrea TOTO

Ortak
Fredri TOTO



NOTER
MARGENA U. ÇELA